

VENDIM
Nr. 64, datë 27.11.2007

**PËR FILLIMIN E PROCEDURAVE TË SHQYRTIMIT TË KËRKESËS SË
SHOQËRISË “ENPOWER ALBANIA” SHPK PËR LICENCIM NË AKTIVITETIN E
NDËRTIMIT, INSTALIMIT DHE SHFRYTËZIMIT TË CENTRALEVE
ELEKTRIKE ME ERË, SI DHE PRODHIMIN E ENERGJISË ELEKTRIKE**

(Ndryshuar me vendimin nr. 78, datë 14.12.2007)

(i përditësuar)

Në mbështetje të nenit 9 dhe nenit 13, pika 1, germa “a” të ligjit nr. 9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, vendimit të Bordit të Komisionerëve nr. 21, datë 4.4.2007 të “Rregullores për procedurat e licencimit” të nenit 10, pika 1, si dhe vendimit të Bordit të Komisionerëve nr. 44, datë 24.7.2007 “Rregullores së praktikës dhe procedurave të ERE-s” nenit 18, Bordi i Komisionerëve, në mbledhjen e tij të datës 27.11.2007, pasi shqyrtoi kërkesën e paraqitur nga shoqëria “Enpower Albania” sh.p.k., për licencimin për aktivitetin e ndërtimit, instalimit dhe shfrytëzimit të centraleve elektrike me erë, si dhe prodhimin e energjisë elektrike

VENDOSI:

1. Fillimin e procedurave për shqyrtimin e aplikimit të shoqërisë “Enpower Albania” sh.p.k., për licencim në aktivitetin e ndërtimit, instalimit dhe shfrytëzimit të centraleve elektrike me erë, si dhe të prodhimit të energjisë elektrike nga këto centrale.

2. *Shfuqizuar.*

3. Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut dhe Drejtoria e Çështjeve Ligjore dhe Mbrojtjes së Konsumatorit ta njoftojnë aplikuesin për dërgimin e dokumenteve të munguara, në përputhje me kërkesat e “Rregullores për procedurat e licencimit”.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI I ERE-S
Bujar Nepravishta